

# AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

## I Dhjetor 2022 I

### Dogana në shifra

Përformanca e Administratës Doganore për muajin dhjetor 2022 ka qënë në nivelet rekord. Realizimi i të ardhurave vetëm gjatë muajit Dhjetor ishte rreth 22 mld lekë, nga 21 mld lekë të planifikuara ose 104,4 %. Ndërkohë që gjatë Dhjetor 2021 të ardhurat ishin në vlerën 20,6 mld lekë.

Rezultati i këtyre të ardhurave vjen si rezultat i rritjes së importeve, miradministrimit si dhe lehtësive të procedurave doganore për biznesin.




### Dogana Online

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet online për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania .

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Këto shërbime kanë krijuar lehtësira për biznesin dhe qytetarët nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi, duke shmangur vonesat dhe burokracitë e panevojshme.

Vetëm gjatë muajit Dhjetor nga DPD janë miratuar 718 shërbime Online, ndërkohë që janë në proces 138 aplikime.



### Bashkëpunimi me partnerët

#### Java e CEFTA : Të zgjerohen Korridoret e Gjelbërta CEFTA-TCT me Bashkimin Evropian

Java tradicionale e CEFTA-s u mbajt këtë vit në Bruksel, ku në fokus ishte bashkëveprimi i politikës tregtare, integrimi rajonal, duke u përqëndruar në rëndësinë e lehtësimit të tregtisë në rajon dhe ndërlidhjet midis tregtisë dhe bashkëpunimit mes komunitetit të biznesit.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli, mori pjesë në konferencën qendrore të CEFTA, " Një hap drejt Tregut Unik të BE-së", që u mbajt këtë të premte, më 9 dhjetor, ku Administratat doganore të Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë dhe Malit të Zi nënshkruan Memorandume Mirëkuptimi, duke zgjeruar më tej Korridoret e Gjelbërta CEFTA-TCT me Bashkimin Evropian.



### Lehtësi për biznesin

#### Shërbimet Doganore marrin vlerësimet pozitive nga biznesi

Shërbimet që jepen nga Administrata Doganore Shqiptare kanë marrë vlerësimet pozitive nga komuniteti i biznesit që aderon në Dhomën Amerikane të Tregtisë.

Kjo është paraqitur në Indeksin e Besimit të Biznesit i Dhomës Amerikane të Tregtisë, ku Doganat kanë marrë vlerësimet më të larta ndër agjencitë publike me mbi 62.5 përqind. Kjo sipas Indeksit të Besimit të Dhomës Amerikane të Tregtisë ka një rritje të kënaqshme për vitet e fundit.

Në prezantimin e Indeksit të Biznesit, marrëdhëniet e Biznesit me Doganat kanë shënuar përmirësim për vitin 2021, duke u vlerësuar një nga indekset më të larta për raportet biznes-institucione publike.

### Info-A e dini se?

Operatori ekonomik autorizohet të depozitojë në një zyrë doganore deklaratën doganore doganore për mallrat të cilat paraqiten në një zyrë tjetër doganore brenda territorit të doganor:

Me zhdoganimin të centralizuar, mund të zgjidhni një zyrë doganore si pikë kontakti të vetme për formalitetet ndërkohë që mallrat paraqiten fizikisht në çdo tjetër zyrë doganore hyrëse të territorit doganor, duke mundur thjeshtim dhe lehtësim të procedurave, ulje të kohës dhe shpenzimeve në transport, si dhe rritje të efektivitetit në shpërndarjen e mallrave.